REPUBLIKA E KOSOVËS / REPUBLIKA KOSOVA
ORGANI SHQYRTUES I PROKURIMIT / TELO ZA RAZMATRANJE NABAVKI
Nr/Br. 39-40-41/17
Datë/Datum. 15.03.2017
PRISHTINË - PRIŠTINA

Republika e Kosovës
Republika Kosova – Republic of Kosovo

ORGANI SHQYRTUES I PROKURIMIT
TELO ZA RAZMATRANJE NABAVKE
PROCUREMENT REVIEË BODY

PSH Nr. 39/17
40/17
41/17

PANELI SHQYRTUES I PROKURIMIT, i emëruar nga kryetari në bazë të nenit 105 dhe nenit 106 të Ligjit për Prokurim Publik të Kosovës nr. 04/L-042, i plotësuar dhe ndryshuar me Ligjin 04/L-237, Ligjin 05/ L-068, dhe Ligjin 05/ L-092, në përbërje prej: z. Blerim Dina- Kryetar, z. Goran Milenković - Referues, z. Nuhi Paçarizi - Anëtar, duke vendosur sipas ankesës së parashtruar nga OE "Mercom Company sh.p.k" - Prishtinë, OE në konsocium "Europa Partner sh.p.k & N.N ABC" - Prishtinë si dhe OE "Astraplan sh.p.k" - Prishtinë, kundër njoftimit për anulim të aktivitetit të prokurimit "Ndërtimi i aneks objektit të Agjencisë për forenzikë-faza II", me nr prok:"214/16/052/521", iniciuar nga autoriteti kontraktues /Ministria e Punëve të Brendshme/, më datën 28 shkurt 2017, mori këtë:

V E N D I M

I. **Aprovohen,** pjesërisht si të bazuara ankesat e OE "Mercom Company'' sh.p.k - Prishtinë, konsorciumit "Europa Partner sh.p.k & N.N ABC"- Prishtinë si dhe OE "Astraplan sh. p. k" - Prishtinë, lidhur me aktivitetin e prokurimit me titull "Ndërtimi i aneks objektit të Agjencisë për forenzikë-faza II", me nr prok: "214/16/052/521",i iniciuar nga autoriteti kontraktues /Ministria e Punëve të Brendshme/.

II. **Anulohet,** njoftimi për anulim të aktivitetit të prokurimit me titull "Ndërtimi i aneks objektit të Agjencisë për forenzikë-faza II", me nr prok: "214/16/052/521", iniciuar nga autoritetit kontraktues /Ministria e Punëve të Brendshme/, dhe lënda kthehet në **Rivlerësim.**

III. Autoriteti Kontraktues në aftë prej 10 ditësh duhet ta informoj me shkrim Panelin Shqyrtues për të gjitha veprimet e ndërmarra lidhur me këtë aktivitet të prokurimit .

IV. Mos respektimi i këtij vendimi, detyron Panelin shqyrtues që konform dispozitave ligjore të nenit 131 të LPP-së nr.04/L-042, të ndërmarr masa ndaj Autoritetit Kontraktues , që nuk respekton vendimin e Panelit Shqyrtues të paraparë me këtë ligj.

V. Operatorëve ekonomik ankues "Mercom Company sh.p.k", OE "EuropaPartners sh.p.k" dhe OE ankues "Astraplan sh.pk" ju kthehet tarifa e sigurimit të ankesës në shumën e deponuar me rastin e parashtrimit të ankesës, pasi që pretendimet ankimore janë aprovuar si pjesërisht të bazuara.

VI. Obligohet operatori ekonomik ankues që konform nenit 36 pika 5 të rregullores së punës së OSHP-së, në afat prej gjashtëdhjetë (60) ditësh të bëjë kërkesë për kthim të sigurimit të ankesës, në të kundërtën ju bëhet konfiskimi i depozitës dhe këto mjete kalojnë në Buxhetin e Republikës së Kosovës.

ARSYETIM

Njoftimi për kontratë në lidhje me këtë aktivitet të prokurimit është bërë me dt:07.11.2016.

Hapja e ofertave është bërë me dt:29.11.2016, ndërsa në këtë aktivitet të prokurimit kanë marr pjesë pesë (5) operatorë ekonomik.

Njoftimi për anulim të kontratës është bërë me dt:27.01.2017.

Kërkesa për rishqyrtim nga ana e operatorit ekonomik "Mercom Company'' sh. p. k - Prishtinë është bërë me dt:30.01.2017.

Kërkesa për rishqyrtim nga ana e operatorit ekonomik "Europa Partner sh.p.k & N.N ABC"-Prishtinë është bërë me dt:27.01.2017.

Kërkesa për rishqyrtim nga ana e operatorit ekonomik "Astraplan sh. p. k"- Prishtinë është bërë me dt :30.01.2017

Me dt:31.01.2017, autoriteti kontraktues ka marr vendim që të refuzohet kërkesa për rishqyrtim e tre operatorëve ekonomik ankues.

Operatori ekonomik "Mercom Company sh.p.k"-Prishtinë, si palë e pakënaqur ka deponuar ankesë në OSHP, me datën 08.02.2017 me nr.prok 39/17, kundër njoftimit për anulim të kontratës të iniciuar nga AK-Ministria e Punëve të Brendshme, me titull: "Ndërtimi i aneks objektit të Agjencisë për forenzikë-faza II", me nr prok: "214/16/052/521", duke pretenduar se autoriteti kontraktues ka bërë shkelje esenciale të dispozitës së LPP-së nr. 04/L-042, i plotësuar dhe ndryshuar me Ligjin 04/L-237, me Ligjin 05/ L-068, dhe Ligjin 05/ L-092, siç janë:

- Neni 6 i LPP-së Ekonomiciteti dhe Efikasiteti paragrafi 1 dhe 2
- Neni 7 i LPP-së Barazia ne trajtim / jo diskriminim paragrafi 1 dhe 2
- Neni 8 i LPP-së Planifikimi i Prokurimit paragrafi 1 dhe 1.3
- Neni 10 i LPP-së Mjetet për promovimin e Transparencës paragrafi 2,3,4,5
- Neni 54 i LPP-së Njoftimi i Kandidatëve dhe Tenderuesve të Eliminuar, paragrafi 1,1.1
- Neni 55 i LPP-së Mënyrat e Komunikimit,paragrafi 1.
- Neni59 i LPP-së Ekzaminimi, Vlerësimi dhe Krahasimi i Tenderëve,paragrafi 2
- Neni 62 i LPP-së Përfundimi i Aktivitetit të Prokurimit,paragrafi 1,1.2
- Neni 72 i LPP-së Dokumentacioni dhe informacioni shtesë
- Neni 39. Rregullat dhe Udhëzuesi Operativ për Prokurimin Publikë
- Neni 113 i Ligjit nr 02/L-28-Mënyra e bërjes se njoftimeve.

Operatori ekonomik "Europa Partner sh.p.k & N.N ABC" –Prishtinë si palë e pa kënaqur ka deponuar ankesë në OSHP, më 09 shkurt 2017 me nr.prok 40/17, kundër njoftimit për anulim të kontratës të iniciuar nga AK- Minstria e Punëve të Brendshme, me titull: "Ndërtimi i aneks objektit të Agjencisë për forenzikë-faza II'', me nr prok: "214/16/052/521'', duke pretenduar se autoriteti kontraktues ka bërë shkelje esenciale të dispozitës së LPP-së nr. 04/L-042, i plotësuar dhe ndryshuar me Ligjin 04/L-237, me Ligjin 05/ L-068, dhe Ligjin 05/ L-092, siç janë:

- Neni 55 i LPP-së (Mënyra e Komunikimit sipas Ligjit të Prokurimit Publik)

Operatori ekonomik "Astraplan sh.p.k"-Prishtinë si palë e pa kënaqur ka deponuar ankesë në OSHP, më 09 shkurt 2017 me nr.prok 41/17, kundër njoftimit për anulim të kontratës, të iniciuar nga AK- Ministria e Punëve të Brendshme me titull: "Ndërtimi i aneks objektit të Agjencisë për forenzikë-faza II'', me nr prok: "214/16/052/521'', duke pretenduar se autoriteti kontraktues ka bërë shkelje esenciale të dispozitës së LPP-së nr. 04/L-042, i plotësuar dhe ndryshuar me Ligjin 04/L-237, me Ligjin 05/ L-068, dhe Ligjin 05/ L-092, siç janë;

- Neni 5 Ndarjet buxhetore të buxhetit të përgjithshëm të Kosovës te projektligj për buxhetin e republikës së Kosovës për vitin 2017
- Nenit 8 i LPP-së nr.04/L-042- Planifikimi i Prokurimit
- Nenit 9 i LPP-së nr.04/L-042- Përcaktimi i nevojave që duhet përmbushur
- Nenit 59 i LPP-së nr.04/L-042- Ekzaminimi, Vlerësimi dhe Krahasimi i Tenderëve
- Nenit 62 i LPP-së nr.04/L-042- Përfundimi i Aktivitetit të Prokurimit

- Nenit 69 i LPP-së nr.04/L-042-Aftësia Teknike dhe/ose Profesionale
- Nenin 39.8 te RRUOPP me tabelën e cekur ne nenin 39.8 kur mungon Lista origjinale duhet te eliminohet OE pa kërkuar sqarime, shih tabelën ne faqen 80 te RRUOPP.

Organi Shqyrtues i Prokurimit, pas pranimit të ankesës, në bazë të nenit 113 të LPP-së, ka autorizuar ekspertin e OSHP-së, për të shqyrtuar vlefshmërinë e të gjitha pretendimeve të palëve ankimore.

Eksperti shqyrtues përmes raportit të datës 24 shkurt 2017, i ka rekomanduar panelit shqyrtues që këtë aktivitet të prokurimit "Ndërtimi i aneks objektit të Agjencisë për forenzikë-faza II'', me nr prok: "214/16/052/521", të iniciuar nga AK-Ministria e Punëve të Brendshme , ta kthej në rivlerësim. Gjithashtu eksperti shqyrtues i propozon panelit shqyrtues që ankesa e OE "Merkom Company sh.p.k", OE "Europa Partners sh.p.k", dhe ankesa e OE "Astraplan sh.p.k", të aprovohen si pjesërisht të bazuara.

Autoriteti kontraktues me datë 27 shkurt 2017, me anë të parashtresës, ka njoftuar OSHP-në, se nuk pajtohet me mendimin e ekspertit shqyrtues.

Operatori ekonomik ankues "Mercom Company sh.p.k" me datë 25 shkurt 2017, me anë të parashtresës, ka njoftuar OSHP-në, se pajtohet plotësisht me mendimin e ekspertit shqyrtues.

Operatori ekonomik ankues "Astraplan sh.p.k" me datë 27 shkurt 2017, me anë të parashtresës, ka njoftuar OSHP-në, se pajtohet pjesërisht me mendimin e ekspertit shqyrtues.

Në seancën e shqyrtimit kryesor të datës 28. 02. 2017, ku kanë qenë prezent paneli shqyrtues, përfaqësuesit i OE ankues, ekspertët e OSHP-së, vëzhguesit nga OJQ "D Plus" ku shqyrtuan shkresat e lëndës duke e bërë kontrollimin dhe analizimin e dokumentacionit për procedurën e prokurimit i cili përbëhet nga: autorizimi i inicimit të aktivitetit të prokurimit, njoftimi për kontratë, procesverbali mbi hapjen e ofertave, vendimi mbi themelimin e komisionit të vlerësimit të ofertave, raporti i vlerësimit të ofertave, njoftimi për anulim e kontratës, ankesa e operatorit ekonomik, raporti i ekspertit të OSHP-së, parashtresat e palëve në procedurë.

Gjatë prezantimit në seancë përfaqësuesi i OE ankues "Mercom Company Sh.p.k", ka deklaruar: "Ne kemi ofruar një ofertë te AK me çmimin më të lirë sipas procesit të hapjes së ofertave me çmim 306,724.72€. Me datë 21.12.2016 nga AK kemi pranuar një email ku na kanë pyetur a pajtoheni për gabime aritmetike të bëra në bazë të kontrolles së paramasës që ka bërë AK .Ne kemi kontrolluar edhe vet dhe kemi konstatuar një gabim prej 3000 e diçka euro, gabime të paqëllimshme teknike që kanë ndryshuar vlerën në një përqindje shumë të vogël që saktësisht është në raportin e vlerësimit të ofertave, pas korrigjimit të gabimeve çmimi ynë është 309,439.63€. Është një gabim me përqindje 0.89%. Kemi analizuar paramasën dh e kremi pranuar gabimin të vazhdohet me procedura të prokurimit. Me 24.01.2017 un kam dërguar një email te AK me pyetje

se ku ka mbetur procesi prokurimit pasi kishin kaluar më shumë se 60 ditë. Autoriteti kontraktues janë përgjigj se shumë shpejt do pranoni njoftimin zyrtar dhe me 26.01.2017 kemi marr një herit edhe raportin për eliminim si dhe anulimin e aktivitetit të prokurimit. AK ka pretenduar se nuk kemi përmbush pikën 9.1 t FTD për përvojën e stafit- konkretisht për përvojën e inxhinierëve ku kërkesa ka qenë projekt menaxheri 3 vite përvojë ndërsa tjerët dy vite, të dëshmuara me diplomë kontratë apo çfarëdo dokumenti që dëshmon përvojën e punës. Ne kemi përmbushur kërkesën e AK-së dhe në takimin për qasje nga dosja origjinale ofertës i kemi dëshmuar me katër dokumente për secilin inxhinier se plotësojmë këtë kërkesë të AK-së. Konkretisht ka pas të bëjë me mua si inxhinier i arkitekturës dhe kam dëshmuar me kopje të diplomës të vitit 2005, kam pas CV me gjitha projektet prej vitit 205, letër referencat nga punë kryes të mëhershëm, listën e stafit me emra dhe përvojë pune ku kanë punuar, dhe regjistrimi i biznesit ku jam vet pronar. Eliminimi ynë është bërë në letër standarde me një shënim poshtë ku thuhet "AK nuk ka qenë të bindur me dëshmitë dhe ka kërkuar sqarim nga ne, gjoja që kanë nis një email me datë 23.012.2016 dhe na ka dhënë afat tri ditë kohë për sqarime dokumenteve tona, mirëpo ky email kurrë nuk ka arritur në adresën tonë. Gjitha komunikimet tjera me AK kanë qenë në rregull përveç këtij emaili. Jemi munduar edh epërmes databazës së YAHOO të vërtetojmë këtë dhe nuk figuron një email i tillë".

Gjatë prezantimit në seancë përfaqësuesi i OE ankues "Europa Partners", ka deklaruar: "Nga AK jemi shpall fitues. Para njoftimit për dhënie të kontratës, kemi pranuar nga AK një letër ku na janë kërkuar dokumentet që kërkohen para dërgimit të njoftimit për dhënie të kontratës , dokumenti i ATK dhe vërtetimi nga gjykata. Kjo nuk ka arritur në adresën tonë. Atëherë ne jemi ankuar pranë AK-së me kërkesë për rishqyrtim, ku kërkesa për plotësim të dokumenteve nuk ka arritur në adresën tonë elektronike. Ne kemi parashtruar ankesë pranë OSHP-së për shkelje të AK-së me rastin e anulimit të aktivitetit të prokurimit".

Gjatë prezantimit në seancë përfaqësuesi i OE ankues "Astraplan", ka deklaruar: "Ne si OE pas pranimit të njoftimit për anulimin e aktivitetit të prokurimit dhe letrës standarde për tenderues të pasuksesshëm konform nenit 10. Par .3 kemi kërkuar qasje pranë AK-së. Pas qasjes në bazë nenit 108. A kemi bërë kërkesë për rishqyrtim për këtë aktivitet. Në përgjigje të dërguar nga AK-MPB arsyetohet dhe refuzohet kërkesa jonë si e pabazuar me vërejtje se nuk mjafton buxheti i paparë për këtë kontratë dhe me arsyetim se janë vetëm dy OE të përgjegjshëm. Pas kësaj kemi kërkuar dhe kemi parashtruar ankesë në OSHP me 41/17 me pretendime se AK ka vepruar kundër nenit 8, 9, 9.2, 9.3, , 59, 62, 69 të LPP dhe 39.8 të UOPP-së dhe neni 5 të ligjit mbi financiar të republikës së Kosovës. Ndërsa në vazhdim do paraqesim faktet e gjetura nga qasja në dokumente pranë ofertave të dorëzuara. Sa i përket pretendimit për buxhet që ka qenë arsyeja kryesore e anulimit, këtë e kemi sqaruar mirë në ankesë dhe po ashtu edhe eksperti e ka sqaruar në sqarimin 2, se anulimi për këtë arsye shtënë kundërshtim me LPP. Buxheti ka qenë i mjaftueshëm dhe është i paraparë në draft buxhetin e vitit 2017 ë për projekte kapitale në vlerë 500.00 pikërisht për forenzikën. Sa i përket ofertuesve më të lirë se ne, sipas raportit të vlerësimit OE më i lirë ka qenë Techno Ing Consuklting sh.p.k dhe ne si Astra Plan sh.p.k, vetëm këta dy OE kanë qenë të papërgjegjshëm. Për të vërtetuar se Europa Partners janë të përgjegjshëm arsyeja nuk qëndron sepse këta kanë dështuar të plotësojnë kërkesat e përshtatshmërisë së tenderit – saktësisht par. 6.8 dhe 7.1 të dosjes së tenderit, dhe mos përgjigjen e tyre ndaj kërkesës së AK, dhe AK para përfundimit i ka eliminuar të papërgjegjshëm, që do thotë vetëm dy oferta janë të përgjegjshme e në

raportin e komisionit vlerësues. Po ashtu ky OE në ofertë nuk ka plotësuar edhe kërkesën e FDT saktësisht neni 11.1 krijimi një grupi të OE-ve sepse nuk ka dorëzuar dokument siç kërkohet me atë nen pika a, b, c dhe dokumentet e paraqitura në dosje nuk janë në përputhje dhe me kërkesën e dosjes. Duke u bazuar rregullën dh e UOPP, neni 39.8, OE i cili dështon të paraqes dhe dështmoj kërkesat kofnrom FDT duhet të eliminohet i papërgjegjshëm në mënyrë administrative sipas nenit 69. Po ashtu mos përgjigja në kërkesën për sqarime apo përshtatshmëri konform nenit 6. 4 dh e 7.1 si vërtetimet e lartcekura, në bazë të nenit 39.7 të rregullave t ë UOPP-së citojmë këtë nen "nëse OE dështon të përgjigjet brenda afatit kohorë të specifikuar nga AK, tenderi përkatës do refuzohet|, me çka AK me drejtë e ka eliminuar të papërgjegjshëm. Mirëpo gabimi i AK ka qenë se nuk ka vazhduar me OE me radhë të përgjegjshëm. Po ashtu sa i përket Mercom Company në qasje dhe duke u bazuar në vlerësimin e AK-së, ky OE nuk ka dorëzuar listën e stafit dhe dështmitë përkatëse sipas kërkesës në FDT dhe një dokument të cilin e ka dërguar në fazën e rishqyrtimit siç është cek në ankesë dhe ekspertizë, është e jashtëligjshme dhe në kundërshtim me LPP, pse se çdo dokument shtesë i dorëzuar përbën ndryshim esencial dhe ndërhyrje në ofertë e çka është e ndaluar me LPP, dh e ka vendim të OSHP për këtë arsye me nr.229/16 , ku pikërisht është eliminuar një OE që nuk ka pranuar dokumentet për Trust dhe listë të ATK pas afatit. Sa i përket arsyes së mos pranimit të emailit nga dy OE-të, mendojmë se OSHP nuk është organ hetues por duhet vendosur sipas dështmive dhe fakteve në dosje. Në qasje AK na ka dështmuar me letrat e dërguara në emailet e tyre. Është për tu çuditur se si kërkesën për sqarime apo për përshtatshmëri nuk e pranuar, ndërsa gjitha kërkesat tjera i kanë pranuar në njëjtën email. Po ashtu dyshojmë se afati i sigurisë ka qenë me 27.02.2017 dhe nuk mendojmë se është e lejuar siguria ofertës pas skadimit dhe ka hapësirë kohore mes dy sigurimeve. Për këta dy OE sikur gjitha kërkesat ti kishin plotësuar, mos përgjigja në kërkesën e AK i bënë të papërgjegjshëm dhe ofertat e tyre duhet refuzuar sipas nenit 39.7 të UOPP. Sa i përket Olti Trasing ky OE është i përgjegjshëm mirëpo gabimet aritmetikore i ka me vlerë më shumë se 2% dh ky OE njëkohësisht është me çmim më të lartë mirëpo është eliminuar për ndryshimin e madhe nga hapja në korrigjime. Sa i përket tekno Ing sh. p k, është shpall i përgjegjshëm nga AK mirëpo në qasje kemi vërejt se edhe ky nuk ka të dorëzuar listën e kontratave konform kërkesës së FTD. Gjithashtu dyshojmë se ky OE nuk ka bërë vazhdimin e sigurimit e as vlefshmërisë së ofertave. Nga sa u tha më lart vjen në radhë oferta e Astraplan që është e përgjegjshme dhe me çmim totalë të lirë konform kërkesës dhe kushteve të tenderit, plotësojmë kushtin tenderi përgjegjshëm me çmim më të ulët.

Gjatë prezantimit në seancë përfaqësuesi i AK-MPB ka deklaruar: "Ju njoftojmë se AK-MPB nuk pajtohet me raportin e ekspertit për ankesën 39-40-41/17 lidhur me aktivitetin e prokurimit "Ndërtimi i objektit aneks të Agjencisë së Forenzikës – Faza -II" me nr.prok.214/16/052/521. Me 07.11.2016 ku është bërë njoftimi në KRPP, MPB ka pas në dispozicion fondet e mjeteve për vlerën e parashikuar 399,587.83€, e nënshkruar nga ZKF me 05.09.2016 para inicimit të aktivitet konform LPP dhe Ligjit për Financa. Afati për ofertim ka qenë 29.11.2016, kriter për dhënie ka qenë tenderi i përgjegjshëm me çmim më të ulët. Hapja publike sipas E Prokurimit është bërë me 29.11.2016, në prani të tre përfaqësuesve të OE pjesëmarrës, të dorëzuara kanë qenë 5 oferta dhe nuk ka pas asnjë vërejtje në hapje. Ndërkohë është themelua komisioni vlerësues që ka kryer punën sipas LPP dhe UOPP-së. Në mënyrën më transparente të mundshme. Gjatë vlerësimit komisioni vlerësues bazuar në nenin 59 dhe 72 ka kërkuar nga të

gjithë pjesëmarrësit sqarime për tenderin. Katër janë përgjigjur pozitivisht përveç Mercom Company që nuk ka kthyer përgjigje ne emailin datë 23.12.2016. Komisioni është detyruar të vazhdoj me tenderuesin e dytë të përgjegjshëm dhe me datë 30.12.2016, i ka dërguar letër standarde për tenderuesin e suksesshëm duke kërkuar që Europa Partners dh e ABC para publikimit të njoftimit për dhënie të dorëzoj këto dokumente. Vërtetimi nga ATK kopje, dhe vërtetimin nga Gjykata departamenti për çështje ekonomike , të dorëzohet deri me 06.01.2017 në orën 15.00 pranë AK-MPB, mirëpo OE nuk është përgjigjur fare në emalin tonë dhe me drejtë është eliminuar. Gjitha këto rrethana kanë ndodhë deri në fund të vitit 2016. Për shkak pretendimet të OE Mercom Company se gjoja ne kemi dërguar email, ne kemi bërë verifikimin e emailëve në arkivin e sistemit të dërgimit të Emaailave nga departamenti për administrim të sistemeve dhe komunikimeve në MPB dhe ASHI – MAP, me çka është nxjerr përfundimi se emailet janë dërguar edhe tek Mercom dhe tek Europa, andaj pretendimet e tyre nuk qëndrojnë. Ndërkohë kam kërkuar nga CERT i MPB-së të verifikoj gjithë emailet e dërguar nga adresa ime zyrtare në këto dy kompani gjatë muajit Dhjetor 2016. Nga përgjigja, pas analizimit të emailave kanë nxjerr përfundim që emailat e datës 23.12.2016 dhe 30.12.2016 janë dërguar nga email tek OE-të, me adresa europaparteners@hotmail.com dhe "mercom2001@yahoo.com, siç shihet në detaje, dhe këtë ja ofroj si dëshmi panelit shqyrtues. Po ashtu në kërkesat për rishqyrtim, OE-të e i kanë dëshmitë se këto emaila janë dërguar prej MPB-së në adresat e tyre. Me 06.01.2017 është aprovuar ligji për buxhetin e vitit 2017, ku mjetet të paraparë për AKF për projekte kapitale janë 500,000€ për vitin 2017. Bazuar në nenin 62 të LPP-së pika 2.1 për shkak të ndryshimeve substanciale në buxhet, edhe pse kanë qenë të planifikuara 399,589.83€, pas krijimit të obligimeve tjera financiare dhje miratimit të ligjit për buxhet vitin 2017, prej 500.000€ na kanë mbetur vetëm 203,402.16€ për këtë projekt, andaj sipas nenit 62 të LPP jemi detyruar të anulojmë këtë projekt. Kjo pasi kemi kontratë aktuale dhe me email të ZKF të nënshkruar nga ZKA nuk është nënshkruar disponueshmëria e mjeteve. Andaj konsideroj se AK-MPB pasi ka shqyrtuar me kujdes pretendimet e OE-ve ankues vjen në përfundim se nuk qëndrojnë pretendimet ankimore, sepse bazuar në nenin 62 të LPP-së për shkak ndryshimeve substanciale në buxhet sipas të dhënave në ZKF është bërë anulimi dhe AK nuk guxon të hyjë në obligime kontraktuale pa mbulesë financiare".

Gjatë prezantimit në seancë ekspertit shqyrtues ka deklaruar: "Sqaroj se si pretendim kryesor i tre OE-ve është anulimi i aktivitetit të prokurimit. Konkretisht arsyetimi i anulimit ku AK ka cek se gjithë tenderët tejkalojnë buxhetin e AK-së. Këtë pretendim ankimorë kundrejt kësaj arsye e kam cilësuar të bazuar,ndërsa arsyetimin anulimit e kam cilësuar të pabazuar pasi për këtë projekt AK sipas shkresave ka deklaratën mbi disponueshmërinë e fondeve në shumë prej 399,587.83€ për këtë projekt dy vjeçar. E njëjta deklaratë është e aprovuar nga ZKA dhe ZKF të AK-MPB, ndërsa çmimet e përshkruara në proces të hapjes së ofertave të gjithsej 5 ofertuesve nuk e tejkalojnë këtë vlerë të paraparë për këtë projekt. Kjo është arsyeja pse kam rekomanduar në rivlerësim , dhe sipas në nenit 62 par. 2 neni par. 2.2 të LPP-së ku sipas këtij neni në këtë fazë nuk lejohet anulimi i aktivitetit të prokurimit. Janë edhe disa pretendime tjera që kam sqaruar përmes raportit, për mos pranim të shkresës elektronike për dokumentet para nënshkrimit të kontratës kundrejt Europa Partners, kam përshkruar situatën dhe i njëjti pretendim është për Mercom Company që nuk i është përgjigj kërkesës për sqarim të dokumentacionit. Përkundër kësaj kërkesë në raport kam sqaruar se për këtë kërkese, sipas shkresave të lëndës së Mercom, pikërisht për arsye

të eliminimit , i njëjti posedon dëshmi dokumentare për njëjtën kërkesë dhe sipas meje nuk ka qenë e nevojshme të kërkohet sqarim. Sa i përket Astraplan, i njëjti përmes ankesës ka kontestuar ofertat me çmime më të lira, mirëpo përmes deklaratës në ankesë nuk ka potencuar rrethana faktike konkrete për shkelje të LPP siç parashihet me nenin 111 par 1.6 të LPP-së, edhe pse tani në seancë i potencoj disa mirëpo nuk ka qenë pjesë e ankesës.

Në fjalën përfundimtare përfaqësuesi i OE ankues "Mercom" ka deklaruar: "I ofrojmë panelit dëshmi nga databaza e YAHOO drejt për drejt , dhe këtu shihet se nuk kemi pranuar email me datën siç pretendon AK. Qëndrojmë pranë ankesës dhe pretendimeve tona ankimore".

Në fjalën përfundimtare përfaqësuesi i OE ankues, "Europa Partners", ka deklaruar "Qëndrojmë pranë ankesës dhe pretendimeve ankimore, dhe i kërkojmë të anulohet vendimi për anulim dhe të vazhdohet aty ku ka mbet komisioni vlerësues".

Në fjalën përfundimtare përfaqësuesi i OE ankues i Astraplan ka deklaruar: "Kërkojmë nga OSHP që sipas neni 104 të LPP të aprovoj ankesën tonë të bazuar, ti refuzoj anesa e Mercom Company dhe Europa Partners si të palejuara, dhe të detyroj AK-MPB të vazhdoj tutje me këtë aktivitet, duke detyruar të bëjë së pari anulimin e njoftimit për anulim, dhe të vazhdoj tutje me OE me radhë i cili plotëson kushtet e dosjes së tenderit dhe është me çmim më i lirë, që në rastin konkret vie në radhë Astraplan".

Në fjalën përfundimtare përfaqësuesi i autoriteti kontraktues ka deklaruar: "Qëndrojmë pranë vendimit të AK-së dhe i propozojmë panelit që të vërtetoj vendimin e AK-së si të bazuar për arsyet që u cekën më lart".

Në fjalën përfundimtare eksperti shqyrtues ka deklaruar: "Qëndroj në tërësi pranë raportit të ekspertizës, si dhe pranë konstatimeve dhe rekomandimeve të dhëna në raportin e datës. 24.02.2017".

Paneli shqyrtues, pas analizimit të të gjitha shkresave të lëndës fakteve dhe provave të prezantuara në seancën për shqyrtim kryesor konstaton se është e paqëndrueshme arsyeja e anulimit të këtij aktiviteti të prokurimit, pasi që në shkresat e lëndës së AK-së ekziston deklarata e nevojave dhe përcaktimi i disponueshmërisë së fondeve ku janë të parashikuara shuma në vlerë prej 399,587.83 € (projekt dyvjeçarë) e cila është e nënshkruar dhe aprovuar nga zyrtari kryesor administrativ (ZKA) dhe zyrtari kryesor financiar (ZKF) i AK-së. Prandaj është e paqëndrueshme arsyeja e anulimit të aktivitetit të prokurimit se të gjithë tenderët e përgjegjshëm përmbajnë çmime që e tejkalojnë buxhetin e AK-së për aktivitetin e prokurimit në fjalë. Vlera e njëjtë e parashikuar tek disponueshmëria e mjeteve është e parashikuar edhe në pikën 2.4 të FDT-së.

Paneli shqyrtues konstaton se data e njoftimit për kontratë është bërë me 07.11.2016 dhe se ky projekt nuk ka mundur të realizohet gjatë vitit 2016 edhe po të nënshkruhej kontrata. Po ashtu për vitin 2017 janë parashikuar për projekte kapitale konkretisht për forenzikën është parashikuar

vlera 500,00.00 €, kjo shihet edhe në tabelën e projektbuxhetit për Buxhetin e Republikës së Kosovës 2017. Prandaj arsyeja e anulimit të këtij aktiviteti të prokurimit është e pabazuar.

Paneli shqyrtues konform nenit 117 të LPP-së vendosi si në dispozitiv të këtij vendimi.

KËSHILLË JURIDIKE:

Kundër këtij vendimi nuk është e lejuar ankesa, por pala e pakënaqur me kërkesëpadi mund t'i drejtohet Gjykatës themelore-Departamentit për çështje Administrative në afat prej 30 ditësh nga data e pranimit të vendimit .

Kryesuesi i Panelit Shqyrtues

Z. Blerim DINA

Vendimi t'i dorëzohet:

1x1 AK – "Ministria e Punëve të Brendshme"

1x1 OE "Mercom Company shpk" -Prishtinë

1x1 OE "Europa Partners shpk" -Prishtinë

1x1OE "Astraplan shpk" -Prishtinë

1x1 Arkivës së OSHP-së;

1x1 Për publikim në Web- faqe të OSHP-së.